

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Tiranë, më 10.06.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Mirëmbajtje teknike e 50 copë aparaturave live skanera të tipeve DS-40, DS-45, DPP-6P dhe Biofad", të ndarë sipas Loteve:

Loti i Parë "Mirëmbajtje teknike të aparaturave live skanera të tipeve DS-40, DS-45, DPP-6P".

Loti i Dytë "Mirëmbajtje teknike e pajisjeve Biofad".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 42961100-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 106,697,700 (njëqind e gjashtë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, ose 1,122,306.72 (Një milion e njëqind e njëzet e dy mijë e trëqind e gjashtë pikë shtatëdhjetë e dy) euro, pa TVSH, të ndarë sipas Loteve:

Loti i Parë "Mirëmbajtje teknike të aparaturave live skanera të tipeve DS-40, DS-45, DPP-6P", me fond limit 105,408,000 (njëqind e pesë milion e katërqind e tetë mijë) lekë pa TVSH, ose 1,108,740.92 (një milion e njëqind e tetë mijë e shtatëqind e dyzet pikë nëntëdhjetë e dy) euro, pa TVSH.

Loti i Dytë "Mirëmbajtje teknike e pajisjeve Biofad", me fond limit 1,289,700 (një milion e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, ose 13,565.79 (trembëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e nëntë euro pa TVSH.

(Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (95.07), datë(10.06.2026)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Shtojca 9 Loti i Parë "Mirëmbajtje teknike të aparaturave live skanera të tipeve DS-40, DS-45, DPP-6P".

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke vlerësuar që plotësimi i kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (202-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Përsa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për të gjitha lotet, rrjedhimisht duhet të kujdeset që vlera për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, të arrijë të plotësojë vlerën e kërkuar për aq lote sa aplikon (të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar), në mënyrë që të arrijë të provojë kapacitetin e tij financiar-ekonomik për mundësinë e realizimit me sukses të të gjitha loteve ku aplikon.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomik-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limitit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Përsa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për të gjitha lotet, rrjedhimisht duhet të kujdeset që vlera për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, të arrijë të plotësojë vlerën e kërkuar për aq lote sa aplikon, në mënyrë që të arrijë të provojë kapacitetin e tij teknik për mundësinë e realizimit me sukses të të gjitha loteve ku aplikon.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;
S SH ISO/IEC 27001 mbi – “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, “ Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;
S SH ISO/IEC 20000-1 “Menaxhimi i shërbimit TI”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Çertifikatat duhet të jenë e lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme Ky standard lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e objektit. Ky standard garanton që operatori ekonomik disponon një sistem të certifikuar për menaxhimin e proceseve, kontrollin e cilësisë së shërbimeve dhe monitorimin sistematik të performancës. Në projekte që përfshijnë infrastrukturë kritike dhe ndërveprim me sisteme shtetërore, mungesa e një sistemi të strukturuar të menaxhimit të cilësisë rrit ndjeshëm riskun e gabimeve teknike, vonesave, moskoordinimit ndërmjet ekipeve dhe defekteve funksionale.

S SH ISO/IEC 27001 mbi – “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, “ Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme; Ky standard lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e sistemit elektronik, i cili operon në mjedis me ndjeshmëri të lartë sigurie dhe përfshin përpunimin dhe transmetimin e të dhënave sensitive, të dhëna biometrike dhe ndërveprim me sisteme shtetërore ekzistuese. Implementimi dhe funksionimi i një sistemi të tillë kërkon menaxhim të strukturuar të rreziqeve të sigurisë së informacionit, kontroll të aksesit, mbrojtje të rrjeteve dhe trajtim të incidenteve kibernetike, në mënyrë që të garantohet konfidencialiteti, integriteti dhe disponueshmëria e të dhënave. Gjithashtu, ky standard dëshmon se operatori ekonomik disponon procese të formalizuara dhe të auditueshme për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit, duke reduktuar riskun operacional dhe ligjor për Autoritetin Kontraktor dhe duke garantuar zbatim të sigurt dhe të kontrolluar të sistemit.

S SH ISO/IEC 20000-1 “Menaxhimi i shërbimit TI”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme. Operimi në mjedisë kufitare me kërkesa të larta sigurie dhe disponueshmërie kërkon procese të strukturuar për trajtimin e incidenteve, menaxhimin e ndryshimeve, kontrollin e konfigurimeve dhe monitorimin e performancës së sistemit. Ky standard dëshmon se operatori ekonomik aplikon praktika të standardizuara dhe të auditueshme për organizimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve TI, duke garantuar funksionim të qëndrueshëm dhe të kontrolluar të sistemit gjatë gjithë ciklit të jetës së kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 8 (tetë) punonjës të siguruar për muajin e fundit nga momenti i hapjes së ofertave, ku të përfshihen jo më pak se 3 (tre) Inxhinierë/Specialistë të siguruar, të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informativi / Informatikë / Informatikë Matematikë / Inxhinieri Matematike dhe Informatikë / Informatikë Ekonomike / Inxhinieri Telekomunikacioni që do të angazhohen në zbatimin e kontratës. Për këta punonjës të paraqitet diploma e kërkuar dhe kontrata e punës e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.

Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën 5 (pesë) specialist të certifikuar për: Mirëmbajtje dhe mbështetje teknike sipas objektit të prokurimit. Për këta punonjës të paraqitet diplomë përkatëse, Certifikatat/dëshmitë e trajnimit dhe kontrata e punës e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Qëllimi i këtij kriteri është të garantojë që operatori ekonomik disponon personel të kualifikuar dhe të certifikuar, i cili është thelbësor për realizimin e kontratës me sukses, duke pasur parasysh specifikat teknike dhe natyrën e shërbimit. Ky kriter është bazuar në analizën e specifikimeve teknike dhe termave të referencës të hartuara nga Autoriteti Kontraktor.

Kërkesa që operatori ekonomik të ketë të paktën 8 (tetë) punonjës të siguruar, ndër të cilët jo më pak se 3 (tre) inxhinierë ose specialistë të diplomuar në fushat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, lidhet me natyrën teknike e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe mbështetjes teknike, të cilat kërkojnë personel të specializuar për administrimin, diagnostikimin, monitorimin dhe zgjidhjen e problematikave që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës. Prania e një numri minimal specialistësh siguron vazhdimësinë e shërbimit, përmbushjen e afateve të reagimit dhe mundësinë për të menaxhuar njëkohësisht kërkesa apo incidente të ndryshme teknike, duke minimizuar rrezikun e ndërprerjeve ose vonesave në ofrimin e shërbimit. Ky shërbim ofrohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Shtrirja gjeografike e shërbimit kërkon disponimin e një stafi të mjaftueshëm për të garantuar mbulimin efektiv të nevojave të autoritetit kontraktor në zona të ndryshme të vendit, si dhe për të siguar reagim në kohë ndaj kërkesave për ndërhyrje teknike.

Kërkesa për të paktën 5 (pesë) specialistë të certifikuar për mirëmbajtje dhe mbështetje teknike lidhet drejtpërdrejt me nevojën për të garantuar një nivel të lartë profesionalizmi dhe ekspertize në

ofrimin e shërbimeve objekt prokurimi. Certifikimet profesionale përbëjnë një dëshmi të verifikueshme të njohurive dhe aftësive teknike të stafit, duke vërtetuar se personeli është trajnuar dhe kualifikuar për të operuar sipas standardeve dhe praktikave më të mira. Kjo kërkesë rrit besueshmërinë e operatorit ekonomik për të përballuar problematika teknike të ndryshme, për të ofruar zgjidhje efektive dhe për të siguruar funksionimin normal dhe të pandërprerë të sistemeve apo pajisjeve që do të mbulohen nga kontrata. Për rrjedhojë, kriteri është në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve të kërkuara, pasi synon të verifikojë kapacitetin real teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë për të garantuar mbështetje teknike cilësore në të gjithë territorin e vendit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër të kryejë shërbimin sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me qëllim që AK të krijojë siguri për që ofertuesi merr përsipër ekzekutimin e kontratës/ave, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Shtojca 9 Loti i Dytë "Mirëmbajtje teknike e pajisjeve Biofad".

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

1.2 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Përsa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për të gjitha lotet, rrjedhimisht duhet të kujdeset që vlera për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, të arrijë të plotësojë

vlerën e kërkuar për aq lote sa aplikon (të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar), në mënyrë që të arrijë të provojë kapacitetin e tij financiar-ekonomik për mundësinë e realizimit me sukses të të gjitha loteve ku aplikon.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bërë në përputhje me nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 42 pika 3, nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se:“ Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 39 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për ”Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 39% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit për këtë lot është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës ”Procedurë e hapur të thjeshtuar ” edhe vlera e kërkuar për xhiron për këtë lot do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi,

dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Përsa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për të gjitha lotet, rrjedhimisht duhet të kujdeset që vlera për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, të arrijë të plotësojë vlerën e kërkuar për aq lote sa aplikon, në mënyrë që të arrijë të provojë kapacitetin e tij teknik për mundësinë e realizimit me sukses të të gjitha loteve ku aplikon.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 42 pika 3 dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 19% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19% të vlerës së fondit limit të lotit 1. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4/b të VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qenë se vlera e fondit për këtë lot është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

S SH ISO/IEC 27001 mbi – “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, “ Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

S SH ISO/IEC 20000-1 “Menaxhimi i shërbimit TI”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Çertifikatat duhet të jenë e lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme Ky standard lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e objektit. Ky standard garanton që operatori ekonomik disponon një sistem të certifikuar për menaxhimin e proceseve, kontrollin e cilësisë së shërbimeve dhe monitorimin sistematik të performancës. Në projekte që përfshijnë infrastrukturë kritike dhe ndërveprim me sisteme shtetërore, mungesa e një sistemi të strukturuar të

menaxhimit të cilësisë rrit ndjeshëm riskun e gabimeve teknike, vonesave, moskoordinimit ndërmjet ekipeve dhe defekteve funksionale.

S SH ISO/IEC 27001 mbi – “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, “ Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme; Ky standard lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e sistemit elektronik, i cili operon në mjedis me ndjeshmëri të lartë sigurie dhe përfshin përpunimin dhe transmetimin e të dhënave sensitive, të dhëna biometrike dhe ndërveprim me sisteme shtetërore ekzistuese. Implementimi dhe funksionimi i një sistemi të tillë kërkon menaxhim të strukturuar të rreziqeve të sigurisë së informacionit, kontroll të aksesit, mbrojtje të rrjeteve dhe trajtim të incidenteve kibernetike, në mënyrë që të garantohet konfidencialiteti, integriteti dhe disponueshmëria e të dhënave. Gjithashtu, ky standard dëshmon se operatori ekonomik disponon procese të formalizuara dhe të auditueshme për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit, duke reduktuar riskun operacional dhe ligjor për Autoritetin Kontraktor dhe duke garantuar zbatim të sigurt dhe të kontrolluar të sistemit.

S SH ISO/IEC 20000-1 “Menaxhimi i shërbimit TI”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme. Operimi në mjedise kufitare me kërkesa të larta sigurie dhe disponueshmërie kërkon procese të strukturuar për trajtimin e incidenteve, menaxhimin e ndryshimeve, kontrollin e konfigurimeve dhe monitorimin e performancës së sistemit. Ky standard dëshmon se operatori ekonomik aplikon praktika të standardizuara dhe të auditueshme për organizimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve TI, duke garantuar funksionim të qëndrueshëm dhe të kontrolluar të sistemit gjatë gjithë ciklit të jetës së kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 2 (dy) punonjës të siguruar për muajin e fundit nga momenti i hapjes së ofertave, ku të përfshihen jo më pak se 1 (një) Inxhinierë/Specialist të siguruar, të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informacioni / Informatikë / Informatikë Matematikë / Inxhinieri Matematike dhe Informatikë / Informatikë Ekonomike / Inxhinieri Telekomunikacioni që do të angazhohen në zbatimin e kontratës. Për keta punonjës të paraqitet diploma e kërkuar dhe kontrata e punës e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.

Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) specialist të çertifikuar për: Mirëmbajtje dhe mbështetje teknike sipas objektit të prokurimit. Për këtë punonjës të paraqitet diplomë përkatëse, Certifikatat/dëshmitë e trajnimit dhe kontrata e punës e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Qëllimi i këtij kriteri është të garantojë që operatori ekonomik disponon personel të kualifikuar dhe të certifikuar, i cili është thelbësor për realizimin e kontratës me sukses, duke pasur parasysh specifikat teknike dhe natyrën e shërbimit. Ky kriter është

bazuar në analizën e specifikimeve teknike dhe termave të referencës të hartuara nga Autoriteti Kontraktor.

Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.3 është në përputhje me natyrën dhe kërkesat e objektit të prokurimit, pasi synon të verifikojë që operatori ekonomik disponon kapacitetet minimale profesionale dhe teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Kërkesa për të paktën 2 punonjës të siguruar, ndër të cilët të paktën 1 (një) inxhinier ose specialist i diplomuar në fushat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, është e arsyeshme dhe proporcionale me nevojat e shërbimit, pasi garanton që operatori ekonomik ka personel të kualifikuar për të kryer aktivitetet e mirëmbajtjes dhe mbështetjes teknike që parashikohen në kontratë. Prania e një specialisti siguron aftësitë e nevojshme për administrimin, diagnostikimin dhe zgjidhjen e problematikave teknike që mund të shfaqen gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

Njëkohësisht, kërkesa për të paktën 1 specialist të certifikuar për mirëmbajtje dhe mbështetje teknike është e lidhur drejtpërdrejt me cilësinë e shërbimit që kërkohet të ofrohet. Certifikimi profesional përbën një provë të aftësive teknike dhe të njohurive të përditësuara të personelit në fushën përkatëse, duke garantuar se shërbimi do të realizohet sipas standardeve profesionale dhe praktikave më të mira të industrisë. Kjo kërkesë ndihmon autoritetin kontraktor të sigurohet që operatori ekonomik zotëron ekspertizën e nevojshme për të ofruar mbështetje teknike efektive dhe për të garantuar funksionimin normal të sistemeve apo pajisjeve që mbulohen nga kontrata.

Për më tepër, kërkesa për praninë e të paktën dy punonjësve siguron që operatori ekonomik të ketë kapacitet minimal organizativ për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit gjatë gjithë periudhës kontraktuale, duke mundësuar zëvendësimin e personelit në rast mungesash apo angazhimesh të njëkohshme. Për rrjedhojë, kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe është vendosur për të garantuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës disponojnë burimet njerëzore dhe kompetencat profesionale të nevojshme për realizimin e suksesshëm të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër të kryejë shërbimin sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me qëllim që AK të krijojë siguri për që ofertuesi merr përsipër ekzekutimin e kontratës/ave, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike.

Specifikimet teknike, termat e referencës, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi i punës i caktuara nga Titullari i Autoritetit kontraktor “Instituti i Policisë Shkencore”, bazuar në nevojat e të cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në Nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.